

Njoftim për shtyp 22 Prill 2020,

Në mbledhjen e tij të radhës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, më datë 27 prill 2020. Veprimtaria e gjykatave do të vijojë sipas kufizimeve të përcaktuara në Aktin Normativ nr.9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.04.2020.

Këshilli i Lartë Gjyqësor rithekson se mbetet i angazhuar maksimalisht për të garantuar sigurinë e publikut, gjyqtarëve dhe të gjithë punonjësve të tjerë të gjykatave. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me këshillat dhe kryetarët në detyrë të gjykatave, është duke punuar intensivisht për marrjen e masave me karakter organizativ dhe administrativ, në mënyrë që rifillimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në çdo gjykatë të bëhet në përputhje dhe respektim të masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19. Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi rifillimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me rregulloren “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si edhe rifillimin e procedurave administrative të pezulluara për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për ngritjen në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, për komandimin në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për komandimin në Shkollën e Magjistraturës dhe për komandimin në Ministrinë e Drejtësisë, duke zgjatur edhe afatet respektive të kandidimit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor do ju informojë në vijimësi në lidhje me zhvillimet e reja dhe ju uron shëndet dhe siguri!